



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

**NR. 39 AKTI**

**NR. 33 VENDIMI**

**Tiranë, më 05.07.2018**

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Etleda Çiftja	Anëtare
Xhensila Pine	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, më datë 03.07.2018, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**

**Z. Luan Kaloçi**, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Apelit Tiranë, përfaqësuar nga avokat Ardian Visha me licencë nr. (\*\*\*) , i pajisur me prokurë të përgjithshme nr. (\*\*\*) rep., nr. (\*\*\*) kol., datë 08.06.2018.

**OBJEKTI:**

**Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Neni 179/b dhe nenet Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,**

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

### **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështje, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesi i tij për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

Subjekti i rivlerësimit, z. Luan Kaloçi, ushtron detyrën e Prokurorit në Prokurorinë e Apelit Tiranë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Duke qenë se z. Luan Kaloçi është kandidat për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar më datë 30 nëntor 2017 me trupin gjykues nr. 4, të përbërë nga komisionere Valbona Sanxhaktari, komisionere Etleda Çiftja dhe komisionere Xhensila Pine në cilësinë e relatores.

Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “ILDKPKI”) sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “DSIK”) sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; Grupi i Punës pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016,

Trupi gjykues nr. 4, me vendimin nr. 1, datë 12.12.2017, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të caktojë me mirëkuptim kryesuesin e trupit gjykues, znj. Valbona Sanxhaktari. Të gjithë anëtarët e trupit gjykues deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

Më datë 01.06.2018, trupi gjykues vendosi:

- i. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Kaloçi, *vetëm* për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke arritur në përfundimin se provat kishin arritur nivelin e provueshmërisë vetëm për këtë kriter, bazuar në nenin 52, paragrafi i dytë, i ligjit nr. 84/2016.
- ii. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, si dhe të marrë një kopje të tyre, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.
- iv. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

Më datë 04.06.2018, me anë të postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, me *e-mail*; (iii) të drejtën për njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

Më datë 18.06.2018, subjekti i rivlerësimit, me anë të përfaqësuesit të tij ligjor dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij së bashku me provat, të cilat u administruan nga ana e Komisionit.

Më datë 22.06.2018, trupi gjykues, me vendimin nr. 3 vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Luan Kaloçi, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 03.07.2018, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i 2-të, Tiranë.

Më datë 03.07.2018 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, avokatit Ardian Visha.

Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të të cilit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Kaloçi, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

## **RIVLERËSIMI I PASURISË**

### ***Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja***

Deklarimi i subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur është dorëzuar në ILDKPKI më datë 31.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ILDKPKI-ja ka dërguar raportin e detajuar lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- është kryer fshehje e pasurisë;
- është kryer deklarim i rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave

### ***Vlerësimi i pasurisë nga Komisioni***

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kreu një hetim administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë të z. Luan Kaloçi.

- 1) **Apartament me sipërfaqe banimi 145 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Njësia Bashkiake Nr. (\*\*\*) Rr. “(\*\*\*)”, p. (\*\*\*) ap. (\*\*\*) Tiranë. Apartamenti është blerë sipas kontratës së datës 26.04.2005 dhe është regjistruar në ZVRPP Tiranë me numrin hipotekor (\*\*\*) Çmimi: 52.000 USD.**

Burimi i krijimit i deklaruar në “Deklaratën-Vetting”: Kontratë kredie bankare nr. (\*\*\*) rep., nr. (\*\*\*) kol., datë 26.04.2005, me Bankën Amerikane (sot “Intesa Sanpaolo”), në vlerën 55 mijë euro.

### **1.Faktet nga hetimi administrativ:**

1.1 Në Deklaratën-Vetting deklarohet apartament me sip. 145 m<sup>2</sup>, në vlerën 52.000 USD.

1.2 Burimi i krijimit të kësaj pasurie, sipas deklarimit në Deklaratën-Vetting është kredia e marrë pranë Bankës Amerikane (sot “Intesa Sanpaolo”) në vlerën 55 mijë euro, disbursuar në datën 04.05.2005.

1.3 Sipas kontratës së shitblerjes me nr. (\*\*\*) rep., nr. (\*\*\*) kol., datë 17.03.2005, mes palës shitëse A. K. dhe palës blerëse Luan Kaloçi për apartamentin e ndodhur në katin e shtatë, me sip. 145.3 çmimi i shitjes është në vlerën 1.500.000 lekë.

1.4 Kontrata e kredisë dhe disbursimi i saj kanë ndodhur më vonë se blerja e pasurisë.

1.5 Në deklarinimin për herë të parë për vitin 2003 deklarohet si e paguar vlera 4.2 milionë lekë dhe si burim për blerjen e këtij apartamenti të ardhurat e siguruar nga shitja e shtëpisë në Elbasan.

1.6 Në deklarinimin periodik për vitin 2005, vlera e kësaj pasurie deklarohet 55 mijë euro.

## **2. Provat e administruara për vërtetimin e fakteve:**

2.1 Shkresa e ZVRPP-së Tiranë<sup>1</sup>, sipas së cilës konfirmohet e regjistruar në emër të z. Luan A. Kaloçi pasuria me nr. (\*\*\*), v. (\*\*\*) fq. (\*\*\*), ZK (\*\*\*), lloji i pasurisë apartament, me sipërfaqe 145.00 m<sup>2</sup>.

2.2 Kontrata e shitblerjes<sup>2</sup> me nr. (\*\*\*) rep., nr. (\*\*\*) kol., datë 17.03.2005, mes palës shitëse A. K. dhe palës blerëse Luan Kaloçi, sipas së cilës apartamenti i ndodhur në katin e shtatë, me sip. 145.3 m<sup>2</sup>, i ndodhur në ZK (\*\*\*), me nr. pasurie (\*\*\*), në Rr. “(\*\*\*)”, shitet në vlerën 1.500.000 lekë.

2.3 Shkresa e OSHEE-së<sup>3</sup>, sipas së cilës konfirmohet në emër të Luan Kaloçit kontrata me nr. (\*\*\*), me status aktiv, në adresën Rr. “(\*\*\*)”, te Tregu Fshatar, *pallati i ri*, me datë hapjeje 16.10.2000.

2.4 Kontrata e shitblerjes<sup>4</sup> me nr. (\*\*\*) rep., nr. (\*\*\*) kol., datë 12.12.2000, sipas së cilës kjo pronë është blerë nga shtetasi A. K. prej shoqërisë “(\*\*\*)” sh.p.k., me një çmim prej 1.990.000 lekësh.

2.5 Shkresat e bankës “Intesa Sanpaolo”<sup>5</sup>, nga ku rezulton një transfertë në vlerën 55.000 euro më datë 05.05.2005, me përfitues A. K.

2.6 Në Deklaratën-Vetting<sup>6</sup> deklarohet apartament me sip. 145 m<sup>2</sup>, blerë sipas kontratës datë 26.04.2005, në vlerën 52.000 USD. Burimi: Kredia e marrë pranë Bankës Amerikane (sot “Intesa Sanpaolo”).

2.7 Në deklarinimin periodik të vitit 2003<sup>7</sup> subjekti deklaron shtëpi banimi, 2+1, e blerë në vitin 2000 në shumën 4.2 milionë lek, me sip. 92 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Rr. “(\*\*\*)”, p. (\*\*\*), ap. (\*\*\*), Tiranë. Burimi: Shitja e shtëpisë në Elbasan në shumën 4.8 milionë lekë, e përfituar nga privatizimi.

2.8 Në deklarinimin periodik të vitit 2005<sup>8</sup>, subjekti deklaron shtëpi banimi, apartament 3+1, sip. 125 m<sup>2</sup>, në shumën 55 mijë euro.

2.9 Deklarata e nënshkruar nga A. K., sipas së cilës ai deklaron se me kërkesën e tij në kontratë u përcaktua vlera e shitjes prej 1.500.000 lekësh, por vlera reale e shitjes ka qenë 52.000 USD.

<sup>1</sup> Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*)prot., datë 11.01.2018, nga ZVRPP Tiranë.

<sup>2</sup> Dërguar me shkresës kthim përgjigje me nr. (\*\*\*)prot., datë 11.01.2018, nga ZVRPP Tiranë.

<sup>3</sup> Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*)prot., datë 12.01.2018, nga OSHEE.

<sup>4</sup> Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*)prot., datë 11.01.2018, nga ZVRPP Tiranë.

<sup>5</sup> Shkresat kthim përgjigje me nr. (\*\*\*)prot., datë 08.01.2018, dhe nr. (\*\*\*)prot., datë 22.02.2018, nga “Intesa Sanpaolo”.

<sup>6</sup> Deklarata e Pasurisë-Vetting, dorëzuar në ILDKPKI më datë 24.01.2017, e gjendur në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>7</sup> Deklarata e interesave private e vitit 2003, dorëzuar në ILDKPKI, më datë 26.03.2004, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>8</sup> Deklarata e interesave private e vitit 2005 dorëzuar në ILDKPKI më datë 23.03.2006, në dosjen e ILDKPKI-së.

## **Deklarimet gjatë seancës dëgjimore :**

2.10 Në përgjigje të pyetjes së bërë nga një nga anëtarët e panelit në seancë dëgjimore, se cila është vlera reale që e ka blerë apartamentin, subjekti i rivlerësimit deklaroi se vlera reale ishte 52.000 USD, dhe kredia e marrë prej 55.000 eurosh i ka kaluar në vitin 2005 shitësit.

2.10.1 Në përgjigje të pyetjes së bërë në seancë dëgjimore nga një prej anëtarëve të panelit se: *“Ju pranoni që është një kontratë fiktive?”*. Subjekti i rivlerësimit, z. Luan Kaloçi, deklaroi se: *“Ka qenë një nga format që mund të përdorej në kushtet që ishim ne”*.

2.11.1 Pyetjes se pse subjekti ka marrë një kredi prej 55 mijë eurosh për një apartament me çmim prej 52.000 dollarësh, avokati i subjektit sqaroi se një veprim i tillë është brenda një logjike ekonomike. *“Kjo është e gjitha brenda një logjike dhe ekonomike. Marrja e kredisë është marrje e parasë hua, marrje e parasë borxh, natyrisht për të përfshirë banesë, që do të jetonte apo jetonte, por edhe për të pasur një likuiditet minimal për të përmirësuar sadopak cilësinë e jetës në atë, dhe është brenda çdo logjike të këtij veprimi juridiko- civil”*.

2.11.2 Pyetjes nga vëzhguesi ndërkombëtar mbi arsyen e vendosjes së një çmimi më të ulët në kontratën e lidhur me kushëririn e tij, subjekti iu përgjigj: *“Arsyeja ka qenë së në periudhën që është blerë shtëpia, ka pasur një ligj që shitësit duhet të paguante, mos gaboj 1 % ose 2 % të vlerës së shitjes së sendit të paluajtshëm, nëse vlera e sendit ishte mbi 2 milionë lekë. Duke qenë në këto kushte, besoj që kjo ka qenë arsyeja, nuk mendoj se ka arsye tjetër”*. Në Shqipëri këto kanë ndodhur në atë periudhë, ka ekzistuar një lloj informaliteti, i cili ishte dhe i papërshtatshëm për kohën.

2.12 Shpjegimet e tij mbas kalimit të barrës së provës, sipas të cilave:

2.12.1 *Sa u takon pasaktësive në lidhje me sipërfaqen e banesës ku jetoj në deklarime të ndryshme, shpjegimi është serish një lapsus e ky fakt mbetet lehtësisht i provueshëm.*

2.12.2 *Në këtë banesë kam filluar të jetoj familjarisht që nga viti 2002. Në vitin 2003, kur kam bërë dhe deklarin për herë të parë, nuk kisha as kontratë shitblerjeje dhe as certifikatë pronësie dhe në këtë mënyrë nuk isha në dijeni se sa ishte sipërfaqja reale.*

2.12.3 *Ndërsa në deklaratën e vitit 2005, deklarimi prej 125 m<sup>2</sup> është thjesht një lapsus, pasi nuk kisha çfarë të fshihja, pasi kam bashkëlidhur dhe kontratën e shitblerjes, ashtu edhe certifikatën e pronësisë, në të cilat përcaktohet se sipërfaqja është 145 metra katrorë, sa është deklaruar edhe në Deklaratën-Veting.*

## **3. Arsyetimi ligjor**

### **3.1 Çmimi i deklaruar i blerjes në Deklaratën-Vetting: 52.000 USD.**

Nuk ka dokumentacion tjetër për të vërtetuar se ky ishte çmimi real i blerjes, përveç një deklarate me shkrim të kushëririt /shitësit të apartamentit.

Nga ana tjetër, ka dokumente të shumta që përmendin një çmim të ndryshëm nga ai i deklaruar në Deklaratën-Vetting:

- Kontrata e blerjes ka çmimin 1.500.000 lekë;
- Huaja me të cilën është paguar shuma, siç subjekti ka deklaruar në Deklaratën-Vetting është -sipas kontratës së huas lidhur me bankën, -në vlerën 55.000 euro;
- Në deklarinin vjetor të pasurisë së subjektit për vitin 2003 çmimi është 4.200.000 lekë;
- Në deklarinin vjetor të pasurisë së subjektit për vitin 2005 çmimi është 55.000 euro.

Në përgjigjen e tij ndaj rezultateve të hetimit, subjekti thjesht përsërit se çmimi real është 52.000 USD, duke paraqitur një deklaratë me shkrim nga shitësi. Kjo deklaratë me shkrim ka vlerë të kufizuar evidentuese, pasi është bërë nga njëra prej palëve në kontratë dhe një i afërm i subjektit dhe është bërë më pas, sipas kërkesës së vetë subjektit. Për më tepër, shpjegimi i tij se kontrata përmend një çmim tjetër me kërkesën e shitësit në mënyrë që shitësi të paguajë më pak tatime, përveç se tregon përfshirjen e subjektit apo gatishmërinë e tij për t'u përfshirë në evazion të mundshëm fiskal, nuk dëshmon se 52.000 dollarë ishte çmimi real. Shpjegimi që mospërputhja mes deklaratës së tij në vitin 2005 (55.000 euro) dhe Deklaratës - Vetting (52.000 USD) është një lapsus /gabim, nuk është i besueshëm. Të bëhen dy gabime në të njëjtën kohë (edhe monedha, edhe shuma) nuk është shumë e besueshme.

### **3.2 Data e blerjes në Deklaratën-Vetting: Kontrata e blerjes 26.04.2005.**

Nuk ka dokumentacion provues për të vërtetuar se kjo ishte data e blerjes.

Përkundrazi, ka dokumente që bien ndesh me këtë datë, si më poshtë:

- Kontrata e blerjes është e datës 17.03.2005.
- Deklarimi i pasurisë së subjektit në vitin 2003 përmend vitin 2000 si vit i blerjes.

### **3.3 Burimi i krijimit është sipas Deklaratës-Vetting: Kredi prej 55.000 eurosh.**

- Kredia ka vlerën e 55.000 eurosh dhe shuma e marrë si kredi është paguar te shitësi (sipas subjektit të rivlerësimit), ndërsa çmimi ishte 52.000 USD.
- Kontrata e kredisë është lidhur më vonë se kontrata e blerjes dhe pagesa e kredisë u bë edhe më vonë se blerja e pasurisë më datë 04.05.2005.
- Çmimi në datën e kontratës së blerjes (17.03.2005) ishte paguar *cash* tashmë jashtë zyrës noteriale.
- Ka mospërputhjen në monedhë dhe konvertojmë shumat në një monedhë (euro ose USD ose lekë), të cilat edhe nëse nuk merren në konsideratë përsëri mbetet një diferencë e konsiderueshme e pashpjegueshme midis çmimit të paguar të blerjes dhe vlerës së kredisë.
- Në deklaratën e pasurisë së subjektit në vitin 2003 subjekti deklaroi se burimi ishte shitja e një shtëpie në Elbasan.
- Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se ai mund të merrte kredinë vetëm pas blerjes së apartamentit, sepse ai duhej ta vendoste banesën si kolateral, pa shpjegime dhe dokumentacion tjetër, nuk është i besueshëm. Shpjegimi i tij se ka një logjikë ekonomike pas diferencës së çmimit të blerjes prej 52.000 USD dhe kredisë së përdorur për blerjen e saj prej 55.000 eurosh nuk është bindës pa sqarime të mëtejshme.
- Subjekti i rivlerësimit ndryshon deklarinë dhe përmend në Deklaratën e Pasurisë-Vetting dhe në përgjigjet e tij ndaj rezultateve të hetimit një burim tjetër nga ai në deklaratën e vitit 2003.

## **4. Baza ligjore**

Bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku dhe duke parë edhe deklaratat vjetore të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të këtij asemi, sipas Nenit D, paragrafi 3, të Aneksit të Kushtetutës.

- ii. Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- iii. Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**2) Hapësirë prej 132 m<sup>2</sup>, sipas kontratës së datës 06.01.2003. E paregjistruar në Hipotekë. Çmimi 5.000.000 lekë.**

**Burimi i krijimit i deklaruar në Deklaratën-Vetting:** Shitja e banesës në Elbasan (e marrë nga Enti i Banesave Elbasan, në këmbim të një banese në Skrapar, e fituar nga ligji i privatizimit të banesave shtetërore).

### **1. Faktet nga hetimi administrativ**

#### **1.1 Mbi vlerën:**

1.1 .1 Në Deklaratën-Vetting <sup>9</sup> është deklaruar 5 milionë lekë, me sip. 132 m<sup>2</sup>.

1.1.2 Në deklaramin e pasurisë së vitit 2003<sup>10</sup>, vlera e kësaj pasurie është deklaruar 5.8 milionë lekë, me sip. 86 m<sup>2</sup>.

1.1.3 Sipas kontratës së sipërmarrjes rezulton se sipërmarrësi V. P. ia ka dhuruar këtë dyqan porositeses.

#### **1.2 Mbi burimin:**

1.2.1. Në Deklaratën-Vetting, si burim krijimi deklarohet shitja e banesës në Elbasan.

1.2.2 Në deklaramin e pasurisë së vitit 2003, si burim për krijimin e kësaj pasurie deklarohen lotaritë sportive "(\*\*\*)" dhe dy hua të marra nga shtetasit H. D. dhe B. Xh., përkatësisht 1.500 000 lekë dhe 700 000 lekë.

1.2.3 Huat e deklaruara në vitin 2003 në shumën 2.200.000 lekë (1.500.000 +700 000) për blerjen e kësaj pasurie nuk paraqiten si detyrime në deklaramet periodike vjetore 2004 - 2016 dhe as në Deklaratën-Vetting.

1.2.4 Në përgjigje të pyetësorit drejtuar subjektit në lidhje me këtë pasuri, ai deklaron se: *“Burimi i krijimit është si nga shitja e shtëpisë në Elbasan, ashtu edhe nga një lotari sportive e fituar nga djali, E. K., në vitin 2003.*

1.2.5 Nga sqarimet e dhëna pranë ILDKPKI-së më datë 18 janar 2016, si dhe kur është kërkuar certifikata e pronësisë dhe kontrata e shitblerjes, subjekti ka sqaruar:

*“Dyqani nuk është i regjistruar në ZVRPP Tiranë. Dyqani është blerë në fazën karabina në shumën 5.800.000 lekë dhe është përfunduar me shpenzimet e mia në shumën rreth 1.200.000 lekë, shpenzime të bëra në vitin 2003. Si burim për kryerjen e shpenzimeve kanë shërbyer të ardhurat e mia nga paga dhe të bashkëshortes. Ndërsa vlera e dyqanit si karabina është mbuluar nga fitimi në lotari sportive, për të cilat kam paraqitur mandatpagesat në kontrollet paraardhëse”.*

#### **1.3 Mbi sipërfaqen e dyqanit:**

<sup>9</sup> Deklarata e Pasurisë-Vetting, dorëzuar në ILDKPKI më datë 24.01.2017, e gjendur në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>10</sup> Deklarata e vitit 2003 e personit që mbart detyrim për deklaram, dorëzuar në ILDKPKI më datë 26.03.2004, e gjendur në dosjen e ILDKPKI-së.

1.3.1 Në Deklaratën-Vetting deklarohet sipërfaqja 132 m<sup>2</sup>.

1.3.2 Ndërsa në vitin 2003 deklarohet 86 m<sup>2</sup>.

## 2. Provat e administruara për vërtetimin e fakteve:

2.1 Kontrata sipërmarrjes<sup>11</sup>, datë 06.01.2003, mes sipërmarrësit V. P. dhe porositësit L. K., me objekt prenotimin nga pala porositëse të një dyqani të ndodhur në katin përdhe, me sipërfaqe 132 m<sup>2</sup>, sipas të cilës referuar nenit 2 dhe 3 të saj, rezulton se sipërmarrësi V. P. ia ka dhuruar këtë dyqan porositëses, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

2.2 Shkresa e OSHEE-së<sup>12</sup>, sipas të cilës konfirmohet në emër të L. K. një kontratë e furnizimit me energji elektrike me nr. (\*\*\*) , me adresë në Rr. “(\*\*\*)”, që nga data 24.02.2005.

2.3 Shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë<sup>13</sup>, sipas së cilës konfirmohet se L. K. ka të regjistruara 2 pjesë (44 m<sup>2</sup> dhe 88 m<sup>2</sup>) të një prone me sip. 132 m<sup>2</sup>, me adresë Rr. “(\*\*\*)”, të regjistruara në kohë të ndryshme.

2.4 Sqarimet e dhëna në ILDKPKI, ku subjekti i rivlerësimit sqaron se pavarësisht se të dy huat e marra për blerjen e dyqanit realisht janë përdorur si garanci për studimet e vajzës në Itali, huat janë marrë dhe janë shlyer brenda vitit.

2.5 Deklaratat e subjektit të rivlerësimit të vitit 2003, 2005 të dorëzuara pranë ILDKPKI-së konsiderohen si provë nga ana e Komisionit, për të verifikuar saktësinë e deklarimeve të bëra në Deklaratën-Vetting, referuar nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i cili parashikon se: “*Deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit*”.

2.6 Sqarimet e subjektit në lidhje me shpenzimet prej 1.2 milionë lekësh për rikonstruksionin apo përfundimin e sipërfaqes prej 132 m<sup>2</sup> blerë në vlerën 5.8 milionë lekë, referuar deklarimeve në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, në vitin 2016.

2.7 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit të 2-të, deklaroi:

*“Sa i takon burimit të blerjes së kësaj pasurie, që në fillim dua t’ju bëj me dije se ai është i ligjshëm dhe për këtë mjafton të shikohen të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes, të ardhurat nga shitja e shtëpisë në Elbasan apo edhe nga lotaria e fituar nga djali im, E. K. Pasaktësitë në deklarin e burimit duhet të vlerësohen si lapsuse apo pakujdesi të miat dhe duhet të kihet parasysh edhe koha e kaluar nga deklarimi i bërë në vitin 2003 me deklarin e bërë në vitin 2017, për efekt vetting-u.”*Në vijim, sqaron se pavarësisht se të dy këto detyrime janë deklaruar për blerje dyqani, realisht janë përdorur si garanci për studimet e vajzës.

2.8 “*Në lidhje me çmimin e shitjes, dua të them që në momentin e blerjes paraprakisht është biseduar që ai të ishte 5.800.000 lekë, shumë e cila do të jepej pjesë-pjesë. Në momentin e deklarin për efekt të vetting-ut, unë kam deklaruar shumë që kam paguar prej 5.000.000 lekësh për blerjen e kësaj pasurie. Diferenca prej 800.000 lekësh është lënë me marrëveshje që do të likuidohej me marrjen e certifikatës së pronësisë, gjë e cila edhe pse kanë kaluar 15 vjet nga kontrata, akoma nuk është bërë”*.

## 3. Arsyetimi ligjor

### 3.1 Çmimi i blerjes:

<sup>11</sup> Shkresë kthim përgjigje, datë 29.01.2018, nga notere M. O.

<sup>12</sup> Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 12.01.2018, nga OSHEE.

<sup>13</sup> Shkresa kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 08.01.2018, nr. (\*\*\*) prot., datë 29.01.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë.



Në Deklaratën-Vetting deklarohet një çmim blerje prej 5.000.000 lekësh.

Nuk ka dokumentacion për të vërtetuar se ky është çmimi real.

Në të njëjtën kohë, ka një numër dokumentesh për të kundërtën:

- Në deklaratën e pasurisë në vitin 2003, subjekti deklarohet një çmim prej 5.800.000 lekësh.
- Në kontratën ndërmjet bashkëshortes së subjektit dhe sipërmarrësit deklarohet si donacion
- Subjekti pranon në përgjigjen e tij për rezultatet e hetimit që çmimi ishte 5.800.000, por shpjegon se ai deklaroi në Deklaratën-Vetting vetëm shumën e paguar deri më tani.
- Ai gjithashtu shpjegon se ka bërë një kontratë fiktive dhurimi. Kjo do të thotë se, përveç që se subjekti ashtu si në lidhje me asetin nr.1 është përfshirë në një kontratë fiktive, ai pranon se nuk e ka deklaruar çmimin real në Deklaratën-Vetting.

### 3.2 Burimi:

- Në Deklaratën-Vetting: Shitja e shtëpisë në Elbasan. Kjo shtëpi është shitur sipas kontratës 200.000 lekë, e cila nuk është e mjaftueshme për të blerë këtë apartament. Për më tepër, subjekti deklarohet në përgjigjet e pyetjeve të Komisionit se burimi ishte edhe paga e tij dhe gruas së tij dhe të ardhurat nga një lotari sportive e fituar nga djali. Nëse supozojmë se kjo është e saktë, atëherë Deklarata-Vetting nuk është e saktë.
- Në deklaratën e 2003-shit, subjekti deklarohet si burim të ardhurat nga një lotari, pa e specifikuar se ishte djali i tij që fitoi lotarinë.
- Subjekti konfirmon se deklarimi në Deklaratën-Vetting nuk ishte e saktë për këtë çështje. Shpjegimi i tij se mosdeklarimi i burimeve të tjera ishte një lapsus në Deklaratën e Vetting-ut nuk është bindës, duke pasur parasysh faktin se sipas mendimit të trupit gjykues ekziston një pasqyrë e pasaktësive në deklaratat e ndryshme të dhëna nga subjekti.
- Subjekti shpjegon se ai mendon që, duke përmendur çmimin 200.000 lekë, është një lapsus i noterit dhe se çmimi real është çmimi i deklaruar në vitin 2003: 4.800.000 lekë. Me sa duket, ai nuk e di këtë gjë me siguri, ky është një lapsus i noterit. Ky shpjegim nuk është i besueshëm sepse është i pabazuar. Gjithashtu, është e vështirë të besohet se subjekti nuk e ka parë çmimin e gabuar në kontratë dhe nuk është e kuptueshme, pa shpjegime të mëtejshme, se pse ai nuk kërkoi korrigjim.

### 4. Baza ligjore

Bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuar së bashku dhe duke parë edhe deklaratat vjetore të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të këtij asemi, sipas nenit D, paragrafi 3, të Aneksit të Kushtetutës.
- Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5, e Aneksit të Kushtetutës.
- Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë sipas nenit 33 të ligjit 84/2016.

**Komisioni, për të vërtetuar faktet dhe rrethanat, administroi nga institucionet dhe vetë subjekti:**

- Shkresë kthim përgjigje, me nr. (\*\*\*)prot., datë 11.01.2018, nga Ministria e Drejtësisë;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 11.01.2018, nga ZVRPP Tiranë;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*)prot., datë 29.12.2017, ZVRPP Skrapar;

- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 04.01.2018, nga ZVRPP Elbasan;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 12.01.2018, nga ZVRPP Elbasan;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 08.01.2018, nga ZVRPP Tiranë;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*)prot., datë 28.02.2018, nga ZVRPP Tiranë;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 03.04.2018, nga ZVRPP Tiranë;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*)prot., datë 20.04.2018, nga ZVRPP Tiranë;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 03.05.2018, nga ZVRPP Tiranë;
- Shkresë kthim përgjigje me nr(\*\*\*)prot., datë 10.01.2018, nga “ProCredit Bank”;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 27.12.2017, nga “Raiffeisen Bank”;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 08.01.2018, nga “Intesa Sanpaolo Bank”;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 22.02.2018, nga “Intesa Sanpaolo Bank”;
- Shkresë kthim përgjigje me nr(\*\*\*)prot., datë 15.01.2018, nga “Union Bank”;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 09.01.2018, nga “BKT”;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*)datë 05.01.2018, nga “Tirana Bank”;
- Shkresë kthim përgjigje me nr(\*\*\*) prot., datë 16.01.2018, nga banka “Credins”;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*)prot., datë 18.04.2018, nga banka “Credins”;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*)prot., datë 03.01.2018, nga Ministria e Brendshme;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 12.01.2018, nga OSHEE;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 03.05.2018, nga OSHEE;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 08.01.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore;
- Shkresë kthim përgjigje me nr(\*\*\*) prot., datë 29.01.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*)prot., datë 31.01.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Shkresë kthim përgjigje, datë 27.12.2017, nga notere V. S.;
- Shkresë kthim përgjigje, datë 17.01.2018, nga notere E. B.;
- Shkresë kthim përgjigje, datë 29.01.2018, nga notere M. Xh.;
- Shkresë kthim përgjigje, datë 23.01.2018, nga noteri E. H.;
- Shkresë kthim përgjigje, datë 25.01.2018, nga noteri L. D.;
- Shkresë kthim përgjigje, me nr. (\*\*\*) prot., datë 03.04.2018, nga ILDKPKI;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 25.01.2018, nga ALUIZNI;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. (\*\*\*) prot., datë 01.02.2018, nga Drejtoria ALUZNI-t “Tirana 2”;
- Shkresë kthim përgjigje me nr.(\*\*\*)prot., datë 26.04.2018, nga ALUIZNI
- **Provat shkresore** të paraqitura nga z. Luan Kaloçi, si më poshtë vijon:
  - Deklarata e z. A. K.;
  - Procesverbalet e deklarimit të dhëna para ILDKPKI-së, datë 18 janar 2016 dhe 16 shkurt 2016;
  - Deklarata e z. H.K.

Trupi gjykues e konsideroi të parëndësishme për vendimmarrjen marrjen e dëshmimeve të z. A. K., z. B. Xh. dhe z. H. D.

## **KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Pas analizimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në Deklaratën e Pasurisë-Vetting, të raportit të ILDKPKI-së, shpjegimeve dhe provave/dokumenteve të paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe avokati i tij, deklarimeve të subjektit me anë të postës elektronike, si dhe ato në seancë dëgjimore dhe pas analizimit të provave shkresore të administruara në zbatim të nenit 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016,

Trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i.** Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive në përputhje me pikën 3 të nenit D të Kushtetutës.
- ii.** Referuar pikës 3, të nenit 61, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, pasi:
  - *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
  - *ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
  - *është kryer deklaram i rremë.*
- iii.** Subjekti ka bërë fshehje të burimit të krijimit të pasurisë dhe deklaram të rremë në Deklaratën-Vetting, si dhe ka dhënë deklarime të rreme në shpjegimet e dhëna.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç dhe D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të z. Luan Kaloçi, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Apelit Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 05.07. 2018.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

#### **KRYESUESE**

**Valbona Sanxhaktari**

#### **ANËTARE**

**Etleda ÇIFTJA**

#### **RELATORE**

**Xhensila PINE**

**Sekretare gjyqësore**

**Anisa DUKA**